

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.D. nga fsh. ... K. Istog, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 i KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.D. av. G.K. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PKR.nr.30/2018 datë 11.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.12.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PKR.nr.30/2018 datë 11.10.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.30/2018 datë 11.10.2018, të akuzuarin A.D. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 i KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 21.11.2017 e gjer me 24.09.2018, e të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënim me gjobë në shumën prej 2000 euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në rast te mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 100 ditësh, ashtu që çdo 20 euro të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg. Të akuzuarit i shqiptohet dënim plotësues: Konfiskimi i substancës narkotike e llojit marihuanë kanabis në peshë të përgjithshme 9097.2 gr. dhe urdhërohet shkatërrimi i saj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, numri i rastit në Polici 2017-DE-511 të dt. 20.11.2017. Konform nenit 9 par.5 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar Ligji 03/L/141, mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar- veturës Smart, tip MC-01, me targa regjistrimi 00-XXX-YZ, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës ti paguaj shumën prej 50 euro, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 euro. I akuzuari obligohet që në emër të programit të për kompensimin e viktimave të paguaj taksën në shumë prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarit N. dhe H.L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.D. av. G.K., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën. aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj asisoj që ndaj të akuzuarit A.D. ti shqiptohet një dënim burgu dhe gjobe më i ulët.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, i akuzuari A.D. edhe pse të ftuar me rregull, kurse prezent ishte mbrojtësi me autorizim zëvendësues av. L.T.. Mbrojtësi mbeti pranë ankësës së parashtruar me shkrim.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.508/2018 të dt. 09.11.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.D. av. G.K. te refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet. .

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit te akuzuarit A.D. av. G.K. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtja në ankesë thekson se meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shprehur pendimin e thelle dhe keqardhjen për veprimet e tij në tërësi pajtohem me te gjitha rrethanat lehtësuese po gjykata është dashur qe ta marrë parasysh edhe si rrethanë lehtësuese se i akuzuari është i martuar , baba i një fëmije të mitur si dhe faktin se disa ditë para përfundimit të kësaj çështje penale nga persona te panjohur është privuar nga jeta vëllai i të pandehurit A.D. dhe tani A. është mbajtësi i vetëm i familjes te dy prindërve te moshuar dhe bashkëshortes dhe fëmijës se mitur te vëllait te tij te ndjerë.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë ne konflikt me ligjin dhe sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë, është penduar për veprën penale duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë të tillë më nuk do ta përsërisë, kërkim faljen publike të dëmtuarve, se është i moshës së re te cilat gjithashtu kjo gjykatë i vlerëson si favorizuese, si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykatë merr faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale kjo sipas vlerësimit te gjykatës paraqet pendim te sinqertë te tij dhe fillim te procesit te

rehabilitimit të tij, dhe në mungesë të ndonjë rrethane rënduese vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.536/18, më 18.12.2018

Procesmbajtës,
Syzana Goxhuli

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____